



Planuar / Doretuar Punijena/Protato Received/Delivry	29.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIPMSHCK	4427/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.560/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr. 560/2022, të datës 23.06.2022, së ankueses me adresë banimi rruga nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.07.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 560/2022 e datës 23.06.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi njoftimi i datës 23.06.2022 i Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 28.04.2022 ka hapur konkursin me numër Reference RN00008925 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 për Ministrinë e Mbrojtjes, ku është përcaktuar afati për aplikim nga data 18.05.2022 deri më datë 04.06.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesja, e cila në bazë të emailit të datës 13.06.2022 është njoftuar që nuk ka plotësuar kushtet e

konkursit konkretisht përvojën e punës prej pesë (50 vitesh në pozita drejtuese, ndërsa ankuesja më datë 16.06.2022 përmes emailit ka kërkuar që rishqyrtohet ky vendim, mirëpo me datë 20.06.2022 përmes emailit të është njoftuar që nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për përvojën punë në pozita drejtuese.

Ankuesja [redacted] me datë 23.06.2022, me numër protokoll 3561/2022, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër zhvillimit të procedurave të Rekrutimit të zhvilluara nga Ministria e Punëve të Brendshme, për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1" në Ministrinë e Mbrojtës".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa me datë 12.07.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.560/2022 e datës 23.06.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 16.06.2022; Akt Emërimi i datës 15.07.2022; Konkursi i datës 28.04.2022; Njoftimi i datës 20.06.2022; Njoftimi i datës 23.06.2022; Vlerësimi i datës 22.06.2022, për vlerësimin përfundimtarë; Renditja përfundimtarë e Kandidateve; Njoftimi i datës 13.06.2022; Vendim i datës 25.06.2021, për emërimin e Komisionit Shtetëror; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; dëshmi nga trusti për datën 01.08.2002, deri me datë 19.11.2021; Vërtetim i datës 27.03.2000; Aktvendim i datës 10.07.2007; Diplomën e datës 01.05.2004 me numër protokoll 398; Certifikatën e vitit 2009; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 26.08.2004 me numër protokoll 511; Vërtetim i datës 02.06.2022; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.07.2009; Akt Emërimi i datës 31.08.2011; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit i datës 10.06.2019; certifikatë e datës 4-19, e muajit maj të vitit 2011; Akt Emërimi i datës 15.07.2011; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 16.08.2018, me numër protokoll 1686; Diplomë e datës 24.10.2016; Vërtetim i datës 11.10.2021; Vërtetim i datës 03.07.2020; vërtetim i datës 09.07.2013; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, Vërtetim i datës 30.05.2022; Vërtetim i marrëdhënies së punës i datës 17.01.2022; Diplomë e datës 07.06.2003; Certifikatë e datës 16-17 e vitit 2022; Certifikatë e datës 20.-21 e muajit shtator të vitit 2018; Certifikatë e datës 18-21, e muajit shtator të vitit 2018; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 09.09.1992; Diplomë e datës 01.06.2013; Vërtetim i datës 03.10.2016; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 03.10.2008, me numër protokoll 1263; Diplomë e datës 01.12.2017, me numër protokoll 970; Vërtetim i datës 02.06.2022; Vërtetim i datës 05.06.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Mirënjohje e datës 27.11.2013; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit të datës 07.06.2019; Kërkesa për punësim e [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 21.09.2007; Vërtetim i datës 02.06.2022; Vërtetim i datës

30.08.2021; Akt Emërimi i datës 01.04.2011; Akt Emërimi i datës 25.03.2022; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Certifikatë e datës 7-8, e muajit maj të vitit 2014; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomën e datës 08.01.2013; Përgjigje në ankesë e datës 12.07.2022, me numër protokolli 4037/2022

Kolegji për shqyrtimin vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, të paraqitura në ankesë e cila pretendon që nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë përvoja e punës në pozita drejtuese konkretisht në organizata ndërkombëtare, duke kërkuar që të kualifikohet për vazhdimin e procedurës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton së në konkursin e shpallur 28.04.2022, për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1" për Ministrinë e Mbrojtjes, kriteret formale të konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to e preferuar në fushat që ndërlidhen me fushëveprimin e institucionit kur rekrutohet.*
- *Së paku (8) vite përvojë pune profesionale,, duke përfshirë së paku pesë (5), vite përvojë punë në pozita drejtuese.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së Ministria e Punëve të Brendshme, Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 13.06.2022, përmes e-mailit zyrtar ankuesen e ka njoftuar së aplikacioni i juaj është refuzuar, për arsye se nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme prej pesë (5) vjet përvojë pune në pozita drejtuese, si rrjedhojë me qëllim të vlerësimit të drejtës, Kolegji, ka shqyrtuar aplikacionin e ankueses të dërguar në kohën e aplikimit dhe ka konstatuar që ankuesja në bazë të diplomës Nr. 398 të datës 10.05.2004 të lëshuar nga Fakulteti Filozofik, dega Gjuhe dhe Letërsie Angleze, ka marr titullin "Profesor", në bazë të vërtetimit të datës 27.04.2022 të lëshuar nga KMDLNJ, ankuesja ka punuar në bazë vullnetare nga muaj dhjetor i vitit 1994, deri në muajin nëntor të vitit 1998. Ankuesja në aplikacionin e dorëzuar ka deklaruar që ka punuar në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë prej datës 15.07.2011 deri më datë 05.04.2016 në pozitën Shef i Sektorit të Verifikimit, duke ofruar edhe pasqyrën e llogarisë nga Trusti, mirëpo e njëjta nuk ka dorëzuar vërtetim të marrëdhënies së punës, sepse neni 7 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përcakton që: *"Aplikacioni si në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë këto të dhëna: një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, kohëzgjatjen e punës, një përshkrim të shkurtër të detyrave, numrin dhe llojin e personelit nën mbikëqyrje, përgjegjësinë buxhetore, adresën e punëdhënësit, arsyet për largimin nga vendi i punës",* mirëpo kjo duhet të mbulohet me dëshmi të përvojës së punës siç parashihet me paragrafi 3 nën paragrafin

3.2 të këtij neni, i cili përcakton se: *“Së bashku me aplikacionin për konkurrim, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues në vijim: 3.2. kopjet e dëshmisë së punësimit që përfshin pozitat dhe datat e mbajtjes së pozitës”,* po ashtu e njëjta nuk ka dëshmuar me prova konkrete që ka përvojë punë në pozita drejtuese prej pesë (5) vitesh siç kërkohet në konkurs si dhe në kriteret e parapara me Shtojca Nr.1/1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 1 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesja, e njëjta nuk ka mundur të dëshmojë që ka përvojën e punës prej pesë (5) vitesh në pozita drejtuese, rrjedhimisht edhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e verifikimit paraprak për rastin e ankueses, ka vepruar në bazë të kompetencave të saj të përcaktuara me nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me nenin 40 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *“2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional”.*

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e mos përfshirjes së ankueses në mesin e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet e konkursit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura dhe kriteret e konkursit, ndërsa që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.560/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankueses

Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe

Arkivit të KPMSHCK-së.